

## PËRMBLEDHJE E MINUTAVE TË TAKIMIT

### KËSHILLI KOMBËTAR PËR EKONOMI DHE INVESTIME (KKEI)

#### TAKIM I RREGULLT

**Prishtinë, 21 prill 2026, 14:00 – 16:30**

Takimi u kryesua nga Kryeministri Albin Kurti, ndërsa u moderua nga Artan Mehmeti, Udhëheqës i Sekretariatit të Këshillit Kombëtar për Ekonomi dhe Investime. Në takim morën pjesë aktive 31 persona, nga ta 25 anëtarë të KKEI, si dhe rreth 10 vëzhgues. Pjesëmarrës ishin përfaqësues të shoqatave vendore të biznesit, të organizatave të huaja, dhe institucioneve shtetërore në Kosovë.

#### **I. Fjala hyrëse nga Kryeministri Albin Kurti, Kryesues i KKEI**

Në fjalën e tij hyrëse përshëndeti dhe falenderoi pjesëmarrësit. Theksoi rëndësinë e dialogut publiko-privat si mekanizëm kyç për bashkëpunim ndërmjet institucioneve dhe sektorit privat. Nënvizoi se, pavarësisht mungesës së disa takimeve formale, komunikimi dhe bashkëpunimi kanë vazhduar përmes angazhimit të Sekretariatit dhe palëve relevante.

Gjatë diskutimit z. Kurti përmendi zhvillimet pozitive ekonomike në Kosovë, përfshirë rritjen ekonomike në vitin 2025 (3.6%), rritjen e investimeve të huaja dhe remitancave, si dhe rolin e tyre në ruajtjen e stabilitetit ekonomik. Po ashtu theksoi për progresin në avancimin e reformave ligjore dhe krijimin e një mjedisi më të favorshëm për biznes, përfshirë një regjim tatimor konkurrues.

Z. Kurti foli mbi mbështetjen konkrete për sektorin privat, veçanërisht për ndërmarrjet e vogla dhe të mesme, përmes investimeve në prodhim, certifikim dhe promovim në tregje ndërkombëtare. Po ashtu, përmendi ratifikimin e marrëveshjeve ndërkombëtare dhe përfitimet e tyre në zhvillimin ekonomik dhe integrimin evropian.

Një vëmendje të veçantë i kushtoi Planit të Rritjes dhe mbështetjes financiare nga Bashkimi Evropian, si mundësi për përshpejtimin e reformave dhe investimeve strategjike.

Në fund, theksoi nevojën për fokus më të madh në zbatimin konkret të reformave, me qëllim përmirësimin e klimës së biznesit, rritjen e investimeve dhe mirëqenies së qytetarëve. Konsideroi

se dialogu është një mekanizëm i rëndësishëm për adresimin e sfidave dhe arritjen e rezultateve konkrete.

**Sergiy Masclichenko, Udhëheqës i EBRD**, theksoi rëndësinë e platformës së dialogut publiko-privat si një nismë efektive për bashkëpunim ndërmjet sektorit publik dhe privat, duke vlerësuar pozitivisht rezultatet e arritura deri më tani. Nënvizoi rëndësinë e rifillimit të aktiviteteve dhe vazhdimësinë e punës përmes takimeve sektoriale dhe diskutimeve të fokusuara edhe jashtë formateve formale. Gjithashtu, theksoi rëndësinë e organizimit të diskutimeve në nivel të lartë për të avancuar më tej bashkëpunimin.

Në fund, vlerësoi lart bashkëpunimin me SECO-n dhe partnerët zviceranë, si dhe shprehu mirënjohje për angazhimin e të gjitha palëve, duke inkurajuar vazhdimin e diskutimeve konstruktive.

## **II. Përmbledhja e diskutimeve**

**Artan Mehmeti, Sekretariati i KKEI**, foli për Ligjin për Pronën Publike dhe ndërveprimin e tij me ligjet e tjera sektoriale që lidhen me shfrytëzimin e pronës publike. Theksoi se, megjithëse ligji ka qenë i nevojshëm për krijimin e një kornize të unifikuar, gjatë zbatimit janë identifikuar paqartësi lidhur me procedurat, kompetencat institucionale dhe harmonizimin me ligje të tjera relevante.

Z. Mehmeti theksoi se këto paqartësi ndikojnë drejtpërdrejt në sigurinë juridike, kohëzgjatjen e procedurave dhe gatishmërinë e bizneseve për të investuar, veçanërisht në sektorë si energjia dhe minierat, ku kërkohet qasje afatgjate në pronë publike.

Gjithashtu, foli për çështjen e vendimmarrjes për dhënien në shfrytëzim të pronës publike, ku aktualisht Qeveria vendos për periudha deri në 15 vite, ndërsa Kuvendi për periudha deri në 99 vite. Kjo u konsiderua si një çështje që mund të ndikojë në investimet afatgjata, andaj do të ishte e dobishme të vihet në diskutim.

Nënvizoi se Ministria e Drejtësisë ka themeluar grup punues për ndryshimin dhe plotësimin e ligjit, duke krijuar një momentum të përshtatshëm për diskutimin dhe adresimin e sfidave. Si opsione, propozoi ndryshimin e vetëm ligjit në fuqi për pronën publike, ose harmonizimin e tij me ligjet e tjera përkatëse përmes nxjerrjes së një pakete të përbashkët ligjore.

**Mazllum Baraliu, Konsulent i jashtëm, DhTIK**, përshëndeti dhe falenderoi të pranishmit. Theksoi se Ligji për Pronën Publike ka shkaktuar probleme serioze në praktikë, përfshirë bllokada, keqinterpretime dhe pengesa të mëdha për bizneset. Vazhdoi duke theksuar se qindra biznese janë prekur negativisht, veçanërisht për shkak të konfliktit dhe mbivendosjes së këtij ligji me ligje të tjera sektoriale si ato për pyjet, minierat dhe ujërat.

Nënvizoi se sistemi aktual është “hibrid” dhe krijon duplikim të kompetencave ndërmjet institucioneve, duke sjellë pasiguri juridike dhe pengesa për investime, përfshirë edhe investime strategjike. Kjo situatë ka shkaktuar dëme të konsiderueshme ekonomike dhe ka ndikuar në rënien e aktivitetit të bizneseve, madje duke çuar disa prej tyre drejt falimentimit.

Z. Baraliu tha se shqetësim i veçantë ishte moszbatimi i një udhëzimi administrativ të Ligjit për Pyjet, i cili ishte diskutuar ndërmjet institucioneve dhe bizneseve, i cili shihet si zgjidhje afatshkurtër për tejkalimin e bllokadave aktuale.

Për fund kërkoi zgjidhje urgjente përmes zbatimit të menjëhershëm të udhëzimit administrativ dhe harmonizimit të Ligjit për Pronën Publike me ligjet sektoriale, duke respektuar parimin që ligjet e veçanta duhet të kenë përparësi në zbatim.

**Genc Nimoni, Zëvendësministër i Drejtësisë**, përshëndeti dhe falenderoi të pranishmit. Sqaroi se Ligji për Pronën Publike është inicuar që nga viti 2016 dhe është miratuar me qëllim krijimin e një kornize të qëndrueshme për administrimin e pronës publike. Megjithatë, gjatë zbatimit janë identifikuar sfida dhe paqartësi, kryesisht për shkak të ndërveprimit me ligje të tjera sektoriale, disa prej të cilave janë miratuar më vonë. Theksoi se Ministria ka trajtuar këto çështje përmes interpretimeve ligjore dhe ndërhyrjeve për zhbllokim të situatave, megjithëse disa probleme mbeten, veçanërisht lidhur me procedurat dhe afatet.

Nënvizoi se në këtë kuadër, është themeluar një grup punues për ndryshimin dhe plotësimin e ligjit, me pjesëmarrjen e institucioneve relevante dhe kontribute nga palët e interesit, përfshirë edhe komunitetin e biznesit dhe se procesi është në fazën përfundimtare, me draftin final që pritet të përmbillet së shpejti.

Gjithashtu foli për angazhimin e harmonizimit të Ligjit për Pronën Publike me ligjet e tjera relevante dhe ftesa për të gjitha palët që të kontribuojnë me komente deri në finalizimin e draftit.

**Besnik Vasolli, OEGJK**, përshëndeti dhe falenderoi të pranishmit. Theksoi se Ligji për Pronën Publike ka krijuar sfida të konsiderueshme, veçanërisht për shkak të mungesës së harmonizimit me ligje të tjera të miratuara më vonë. E vlerësoi dokumentin e përgatitur nga Sekretariati për identifikimin e qartë të problemeve dhe sfidave në zbatim.

Nënvizoi se bizneset, përfshirë anëtarët e Odës, janë prekur nga paqartësitë ligjore dhe kompleksiteti i procedurave, ndërsa u theksua nevoja për një qasje më gjithëpërfshirëse në adresimin e këtyre çështjeve. Si rekomandim kryesor propozoi zgjerimin e grupit punues për të përfshirë edhe përfaqësues të sektorit privat dhe palë të tjera të interesit, me qëllim hartimin e një zgjidhjeje më të qëndrueshme dhe të harmonizuar. Gjithashtu, sugjeroi shqyrtimin e praktikave ndërkombëtare (si rasti i Kroacisë) për thjeshtimin e procedurave vendimmarrëse.

Theksoi urgjencën për zgjidhjen e problemeve ekzistuese dhe gatishmërinë e Odës për të kontribuar aktivisht në procesin e reformës dhe konsultimeve.

**Artan Mehmeti, Sekretariati i KKEI**, foli për çështjen e njohjes së humbjeve natyrore të produkteve ushqimore për qëllime tatimore. Nënvizoi se këto humbje janë të pashmangshme gjatë transportit, magazinimit dhe shitjes, por aktualisht nuk njihen qartë në praktikë, duke krijuar barrë tatimore për bizneset edhe për mallra që realisht nuk ekzistojnë.

Sqaroi se baza ligjore për njohjen e këtyre humbjeve ekziston në legjislacionin tatimor, por mungon një akt nënligjor që do të përcaktonte normat dhe procedurat konkrete për zbatim. Kjo situatë ndikon negativisht në bizneset, duke rritur kostot, duke nxitur informalitetin dhe duke ulur konkurrueshmërinë e prodhuesve vendorë në raport me rajonin.

Theksoi se sipas analizave preliminare, humbjet e produkteve ushqimore mund të arrijnë vlera prej 20–31 milionë euro në vit, ndërsa barra tatimore mbi këto humbje vlerësohet nga 3.16 deri në 4.75 milionë euro duke u bazuar në të dhënat e vitit 2024 dhe skenarë të ndryshëm të normave të humbjes.

Përmendi edhe praktikën e vendeve të rajonit, si Kroacia, ku humbjet njihen pjesërisht sipas hallkave të zinxhirit të furnizimit. Kërkoi angazhim nga Ministria e Financave për hartimin e akteve nënligjore dhe trajtimin e kësaj çështjeje, përfshirë mundësinë e angazhimit të ekspertizës profesionale.

**Hartim Gashi, PePeKo**, përshëndeti dhe falenderoi të pranishmit. Theksoi se mosnjohja e humbjeve natyrore të produkteve ushqimore vazhdon të jetë një barrë e rëndësishme për prodhuesit vendorë, duke ndikuar negativisht në konkurrueshmërinë e tyre në raport me rajonin.

Ai tha se një problem i shtuar i viteve të fundit janë praktikën e inspektimeve tatimore, të cilat kanë çuar në raste të shumta kontestesh gjyqësore ndërmjet bizneseve dhe administratës tatimore, e që kjo situatë krijon kosto dhe ngarkesë si për bizneset ashtu edhe për institucionet publike.

Z. Gashi përmendi një ndër shqetësimet kryesore mungesën e standardizimit në njohjen e humbjeve, duke lënë hapësirë për interpretime subjektive dhe vendimmarrje diskrecionale nga zyrtarët tatimorë ose nga vetë bizneset. Kërkoi që çështja të adresohet urgjentisht përmes nxjerrjes së akteve nënligjore, në përputhje me legjislacionin ekzistues, me qëllim të krijimit të rregullave të qarta dhe të standardizuara. Nënvizoi se bizneset preferojnë zgjidhje institucionale dhe jo përballje përmes proceseve gjyqësore. Theksoi se kjo çështje është ngritur edhe në takime me institucionet relevante dhe pritet një zgjidhje në të ardhmen e afërt.

**Hekuran Murati, Minister i Financave**, sqaroi se është planifikuar vazhdimi i punës përmes një grupi punues dhe hartimi i një akti nënligjor, udhëzim administrativ, që do të përcaktojë mënyrën

dhe masën e njohjes së humbjeve natyrore të produkteve. Ttheksoi se humbjet aktualisht njihen në parim, por kërkojnë dokumentim dhe verifikim nga inspektorët tatimorë, gjë që krijon ngarkesë procedurale për bizneset dhe hap hapësirë për diskrecion në vlerësim. Si zgjidhje përmendi mundësinë e thjeshtimit të procedurës përmes përcaktimit të normave fikse të humbjes: njohje automatike sipas përqindjeve të caktuara. Gjithashtu theksoi se vonesat në trajtimin e kësaj çështjeje lidhen edhe me mungesën e institucioneve funksionale gjatë vitit të kaluar, ndërsa tani pritët që me funksionalizimin e Qeverisë të vazhdohet me konsultimet dhe finalizimin e udhëzimit. Ritheksoi se qëllimi është thjeshtimi i procedurave tatimore dhe lehtësimi i barrës për bizneset.

**Mentor Hyseni, Dretjor i ATK-së,** theksoi se pas takimeve me Odën Gjermane dhe përfaqësues të sektorit të bujqësisë, është krijuar një grup punues në bashkëpunim me Doganën e Kosovës për trajtimin e çështjes së njohjes së humbjeve natyrore të produkteve. Po ashtu theksoi se janë mbledhur informacione dhe ekspertiza nga palët e përfshira, dhe se materiali përkatës është në fazë të avancuar dhe i gatshëm për finalizim sapo të përmyllen procedurat institucionale. Qëllimi është që procesi të ecë pa vonesa drejt miratimit.

Nënvizoi nevojën për standardizim të rregullave, në mënyrë që të shmanget gjykimi subjektiv i inspektorëve tatimorë dhe trajtimi jo i njëtrajtshëm i bizneseve dhe tha se zgjidhja synon të bazohet në kritere të qarta dhe të verifikueshme për dokumentimin e humbjeve. Ritheksoi angazhimin për finalizimin e shpejtë të procesit dhe për krijimin e një sistemi më të drejtë dhe më të thjeshtë për bizneset.

**Artan Mehmeti, Sekretariati i KKEI,** duke përmyllur diskutimin mbi këto dy çështje, ai përmyllodhi angazhimet e theksuara gjatë këtij takimi. Në këtë kontekst, u tha se: 1) Ministria e Financave do të vijojë punën për nxjerrjen e aktit përkatës lidhur me njohjen e humbjeve natyrore; dhe 2) Ministria e Drejtësisë do të vazhdojë procedurën për rishikimin e Ligjit për Pronën Publike. Me këtë rast, z. Mehmeti shprehu edhe gatishmërinë, në cilësi të Sekretariatit të KKEI, për të kontribuar me ekspertizën e nevojshme në këtë proces, si dhe për të fasilituar diskutimin konstruktiv drejt një zgjidhje të përshtatshme.

**Mimoza Kusari Lila, Ministre, MINT,** përshëndeti dhe falenderoi të pranishmit. Znj. Kusari Lila foli për masat e përkohshme për produktet bazike në rastet e destabilizimit të tregut. Theksoi se ligji është rikthyer pas zhvillimeve të lidhura me vendimin e Gjykatës Kushtetuese dhe krizën e shkaktuar nga rritja globale e çmimeve pas luftës në Ukrainë.

Sqaroi se projektligji parasheh mekanizma për vendosjen e masave të përkohshme si çmimet tavan dhe kufizimi i marzheve tregtare në rastet e rritjeve të papritura të çmimeve. Këto masa do të bazohen në metodologji të përcaktuara dhe do të zbatohen nga një bord i pavarur prej pesë anëtarësh, tre prej të cilëve janë jashtë institucioneve dhe zgjidhen nga Kuvendi.

Nënvizoi se disa dispozita të draftit të mëparshëm janë hequr, pasi mbulohen nga ligjet ekzistuese për tregtinë e brendshme dhe masat antidamping. Tha se kohëzgjatja e masave është e kufizuar në periudhën e destabilizimit të tregut, deri në rreth 60 ditë.

Theksoi se qëllimi i ligjit është krijimi i një baze ligjore për ndërhyrje në situata të jashtëzakonshme të rritjes së çmimeve dhe jo kontroll i përgjithshëm i tregut. Projektligji aktualisht ndodhet në procedurë parlamentare dhe pritet të kalojë në leximin e dytë, ndërsa paralelisht do të procedohet me krijimin e bordit pas miratimit të tij. Procesi është zhvilluar me procedurë të përsheptuar, por me përfshirje të palëve të interesit, përfshirë bizneset dhe organizatat përkatëse.

Znj. Kusari Lila nënvizoi se Kosova Invest vazhdon të funksionojë me rregulloren dhe proceset e saj të rekrutimit, ndërsa Agjencia Kosovare për Inovacion dhe Ndërmarrësi (AKIN) është në fazën përfundimtare të themelimit, me draft-rregulloren e brendshme dhe pritet miratimi në Qeveri, si dhe transferimi i funksioneve nga KIESA.

Sqaroi ndarjen e roleve institucionale se Kosova Invest, në kuadër të Zyrës së Kryeministrit, fokusohet në promovimin e investimeve dhe eksportit me rol ekzekutiv, ndërsa MINT ka rol në politikëbërje. Mbështetja për ndërmarrjet e vogla dhe të mesme, si dhe startup-et, mbeten në kuadër të agjencisë pranë Ministrisë. Gjithashtu, foli për krijimin e dy divizioneve të reja brenda agjencisë, siç janë Divizioni për Bizneset e Grave dhe Divizioni për Startup-et, me synim fuqizimin e ndërmarrësisë, përfshirë edhe promovimin e edukimit dual dhe zhvillimin e kulturës sipërmarrëse që nga arsimit mesëm.

**Mazllum Baraliu, Konsulent, DhTIK**, theksoi se projektligji aktual përmban hapësira të gjera për rregullime nënligjore, të cilat mund të krijojnë paqartësi dhe vonesa në zbatim, si dhe rrezik për tejkalim të kornizës ligjore. Ngriti shqetësimin se këto paqartësi mund të çojnë në konteste gjyqësore dhe potencialisht edhe në arbitrazh ndërkombëtar, me pasoja të konsiderueshme financiare si për shtetin ashtu edhe për bizneset. Potenco gjithashtu se rasti i moszbatimit të udhëzimeve ekzistuese administrative, i cili mund të eskalojë në procese gjyqësore në Gjykatën Supreme dhe jashtë vendit nëse nuk adresohet në kohë.

Kërkoi që, pavarësisht fazës së avancuar të projektligjit në Kuvend, të ketë hapësirë shtesë për debat dhe konsultim gjithëpërfshirës me sektorin privat, me qëllim hartimin e një ligji më efikas dhe të zbatueshëm. Theksoi rëndësinë e bashkëpunimit ndërmjet Qeverisë dhe sektorit privat, si dhe nevoja për përmirësim të zbatimit të ligjeve, duke shmangur kolizionet dhe interpretimet e ndryshme që shpesh çojnë në zgjidhje gjyqësore.

**Bujar Kelmendi, OEK**, përshëndeti dhe falenderoi të pranishmit. Sqaroi se që në fazën e hershme të hartimit të projektligjit për masat e tregut, Oda ka shprehur gatishmëri për ta mbështetur ligjin në interes të qytetarëve dhe zhvillimit ekonomik, duke ruajtur njëkohësisht balancën me interesat e bizneseve.

Nënvizoi se Oda ka marrë pjesë aktive në konsultime me Ministrinë e Tregtisë dhe grupin punues, duke dhënë rekomandime dhe opinione të detajuara për përmirësimin e projektligjit. Theksoi rëndësinë e një ligji të qartë dhe të zbatueshëm, pasi paqartësitë në mekanizmat e zbatimit mund të krijojnë boshllëqe dhe vështirësi si për bizneset ashtu edhe për qytetarët. Si rekomandime kryesore, Oda kërkoi:

1. Ndarje të qartë të kompetencave institucionale brenda mekanizmit vendimmarrës (bordit), për të shmangur paqartësitë në inicim, vendim dhe kontroll;
2. Përfshirje të përfaqësuesve të bizneseve, shoqërisë civile dhe ekspertëve në bordin vendimmarrës për të siguruar vendime më të balancuara dhe profesionale;
3. Përcaktim të qartë dhe konkret të artikujve dhe çmimeve në ligj, për të minimizuar diskrecionin administrativ (p.sh. specifikimi i produkteve bazike dhe standardeve të çmimeve).

Po ashtu theksoi se një ligj i mirëstrukturuar, i qartë dhe i harmonizuar me interesat e qytetarëve dhe bizneseve do të lehtësonte zbatimin dhe do të siguronte efikasitet më të lartë në praktikë.

**Arieta Pozhegu, ShPDK**, përshndeti të pranishmit. Ngriti disa çështje kryesore lidhur me sektorin e pylltarisë dhe industrinë e drurit. Potencoi mungesën e certifikimit dhe menaxhimit të qëndrueshëm të pyjeve në Kosovë, duke nënvizuar nevojën për investime dhe një plan afatgjatë për certifikimin dhe mirëmenaxhimin e tyre, si praktikë e aplikuar në vende të rajonit. Si shembull, ajo përmendi planifikimin e ngrohtoreve me biomasë, duke theksuar se nevojitet rregullim dhe organizim për mbledhjen dhe shfrytëzimit e saj. Sipas saj, kjo mund të krijojë sfida në fazën e zbatimit.

Theksoi se industria vendore e drurit vazhdon të varet nga importi i lëndës së parë, ndërsa potenciali i madh i pyjeve vendore mbetet i pashfrytëzuar për shkak të mungesës së investimeve dhe planifikimit të integruar. Ngriti shqetësimin për mungesën e koordinimit në përdorimin e biomasës dhe mbetjeve drusore, gjë që krijon vështirësi për zhvillimin e sektorëve si prodhimi i peletit dhe energjia nga biomasa. Po ashtu theksoi se mungesa e promovimit të industrisë së Kosovës në tregjet ndërkombëtare dhe nevoja për një strategji më të qartë të përfaqësimit dhe pjesëmarrjes në ekspozita dhe aktivitete B2B. Gjithashtu kërkoi një rol më aktiv dhe të barabartë për odat ekonomike dhe shoqatat e biznesit në projektet dhe vendimmarrjen institucionale.

Znj. Pozhegu foli edhe për mungesën e fuqizimit të arsimit profesional dhe nevojën për promovimin e shkollave profesionale, me qëllim rritjen e aftësive të të rinjve dhe përgatitjen e tyre për tregun e punës dhe industrinë prodhuese.

**Mimoza Kusari Lila, Ministre, MINT**, informoi se në diskutim mbi projektligjin për masat e përkohshme për produktet bazike, ligji është hartuar në përputhje të plotë me vendimet e

Gjykatës Kushtetuese dhe nuk synon kontroll të përhershëm të çmimeve në treg, por vetëm ndërhyrje të kufizuara në raste të destabilizimit të tregut. Sqaroi se vendosja e masave si çmimet tavan apo marzha tregtare aktivizohet vetëm në situata të jashtëzakonshme dhe për një listë të kufizuar produktesh bazike, ndërsa lista specifike e produkteve si: mielli, vaji, qumështi etj përcaktohet dhe publikohet nga bordi i pavarur.

Sa i përket strukturës së bordit, theksoi se është i dizajnuar për të shmangur konfliktin e interesit, duke përjashtuar përfaqësuesit me interesa të drejtpërdrejta biznesore apo politike, në përputhje me aktgjykimin e Gjykatës Kushtetuese. Inicimi i masave mund të bëhet nga palë të ndryshme, vendimarrja i takon bordit, ndërsa kontrolli realizohet nga inspektorati.

Gjithashtu tha se bordi nuk ka funksion të përhershëm operacional, por mblidhet vetëm sipas nevojës, duke reduktuar ndjeshëm kostot administrative. Struktura përfshin anëtarë ex-officio nga institucionet përkatëse dhe anëtarë të zgjedhur me konkurs të miratuar nga Kuvendi. Ritheksua se qëllimi i ligjit është menaxhimi i situatave të krizës dhe mbrojtja e konsumatorit, duke ruajtur parimet e ekonomisë së tregut të lirë.

**Artane Rizvanolli, Ministre, ME,** nënvzoi se përdorimi i diskrecionit në zbatimin e ligjeve dhe skemave publike është i rëndësishëm për të lejuar mësim nga praktika dhe përmirësim të vazhdueshëm të politikave, megjithëse u pranua se specifikimi i tepërt në ligj mund të krijojë edhe rreziqe për zbatim jo fleksibil dhe vështirësi në ndryshime të shpejta.

Sa i përket sektorit të energjisë dhe biomasës, sqaroi se ngrohtoret e reja nuk planifikohen të bazohen ekskluzivisht në biomasë, por vetëm në kombinim me burime të tjera. Theksoi mungesën e bashkëpunimit institucional për shfrytëzimin e biomasës nga pyjet, pavarësisht iniciativave për koordinim ndërinstitutional dhe subvencionim të pajisjeve.

Znj. Rizvanolli foli gjithashtu për progresin në liberalizimin e tregut të energjisë, ku çmimet aktuale janë dukshëm më të ulëta se parashikimet fillestare, si dhe theksoi se janë zbatuar masa mbështetëse për bizneset përmes skemave dhe trajnimeve me partnerë institucionalë dhe ndërkombëtarë.

Në fund, foli për skemat e granteve për efikasitet të energjisë dhe pajisje të qëndrueshme, të implementuara në bashkëpunim me KIESA dhe partnerë zhvillimorë, me mundësi rishpalljeje për bizneset që nuk kanë përmbushur kriteret për arsye teknike.

**Armend Muja, Ministër, MBPZHR,** theksoi se potenciali i pyjeve për prodhimin e biomasës dhe zhvillimin e industrisë së përpunimit është i konsiderueshëm, por deri tani nuk është shfrytëzuar plotësisht për shkak të dështimit të disa procedurave të tenderimit. Aktualisht po analizohen arsyet e këtyre dështimeve dhe është paralajmëruar hartimi i një programi kombëtar të forcuar për pyjet që do të adresojë çështjet e identifikuara.

Në lidhje me studimin e prezantuar, u identifikuan disa mangësi kryesore:

1. Paqartësi në ndarjen e kompetencave në procesin e lejeve ndërtimore, ku në disa raste aplikohen gabimisht procedura komunale për kategori toke që kërkojnë trajtim nga niveli qendror, duke shkaktuar vonesa administrative.
2. Kufizimet në zonat e shpallura parqe nacionale, ku aktivitetet ekonomike nuk mund të zhvillohen pa vendim të ri institucional për ndryshimin e statusit të tyre.
3. Nevoja për harmonizim ndërmjet ligjit për pronën publike dhe Ligjit për Miniera dhe Minerale, veçanërisht për çështjen e guroreve dhe zonave të përjashtuara nga licencimi, të cilat janë të përcaktuara me ligj dhe vendime që nga viti 2010.

Nënvizoi rëndësinë e koordinimit ndër-institucional për të shmangur interpretimet e ndryshme ligjore dhe për të përmirësuar zbatimin në praktikë.

**Albin Kurti, Kryeministër, Kryesues i KKEI**, nënvizoi rëndësinë e komunikimit të vazhdueshëm ndërmjet institucioneve dhe sektorit privat, duke nënvizuar se ministrat dhe institucionet përkatëse duhet të jenë plotësisht të qashtë për adresimin e pengesave dhe paqartësive të bizneseve.

Vlerësoi sektorin privat si motor kryesor të zhvillimit ekonomik dhe punësimit në vend, ndërsa theksoi si sfidë afatshkurtër dhe afatmesëm mungesën e fuqisë punëtore të kualifikuar, si dhe hendekun mes kërkesave të tregut të punës dhe sistemit të arsimit profesional.

Z. Kurti theksoi rëndësinë e orientimit strategjik për rritjen e arsimit profesional dhe përmirësimin e cilësisë së shkollave profesionale, si dhe zgjerimin e profileve të tyre. Gjithashtu propozoi forcimin dhe zhvendosjen graduale të sistemit të arsimit dual drejt Ministrisë së Industrisë, Ndërmarrësisë, Tregtisë dhe Inovacionit, në linjë me praktikën e vendeve të zhvilluara evropiane.

Për fund, z. Kurti tha se qëllimi kryesor është përafrimi i sistemit arsimor me nevojat e tregut të punës dhe rritja e matshme e efektivitetit të arsimit dual në funksion të ekonomisë.

**Permbyllja e takimit.**

## LISTA E PJESËMARRËSVE

### Përfaqësuesit nga institucionet publike:

1. Kryeministri, kryesues;
2. Ministri i Financave;
3. Ministria e Ekonomisë;
4. Ministri i Bujqësisë, Pylltarisë, dhe Zhvillimit Rural;
5. Ministri për Zhvillim Rajonal;
6. Ministria e Kulturës dhe Turizmit;
7. Ministria e Industrisë, Ndërmarrësisë dhe Tregtisë;
8. Ministri i Financave;
9. Ministri i Zhvillimit Rajonal;
10. Zëvendësministri i Ministrisë së Drejtësisë;
11. Zëvendësministri i Administrimit të Pushtetit Lokal;
12. Përfaqësues i Bankës Qëndrore të Kosovës;
13. Drejtori i Përgjithshëm i Administratës Tatimore të Kosovës;
14. Drejtori i Përgjithshëm i Doganës të Kosovës;
15. U.D. Drejtor i Përgjithshëm i KIESA;

### Përfaqësuesit nga odat dhe shoqatat e bizneseve:

16. Përfaqësues i Odës Ekonomike të Kosovës (OEK);
17. Drejtori Ekzekutiv i Odës Ekonomike Gjermano – Kosovare (OEGJK);
18. Përfaqësues i Odës Ekonomike Amerikano – Kosovare (AmCham);
19. Drejtori Ekzekutiv i Odës Turke në Kosovë;
20. Kryetari i Bordit të Dhomës së Tregtisë dhe Industrisë së Kosovës (DhTIK);
21. Drejtorja Ekzekutive e Shoqatës së Përpunuesve të Drurit të Kosovës (SHPDK);
22. Drejtori Ekzekutiv i Kllasterit të Industrisë së Metalit dhe Energjisë së Ripërtërishme në Kosovë (KIMERK);
23. Drejtori Ekzekutiv i Shoqatës për përpunimin e Pemëve dhe Perimeve të Kosovës (PePeKo);
24. Drejtore e Kllasterit të Ndërtimeve të Parafabrikuara të Kosovës (PREFAB);
25. Drejtore e Dhomës Ekonomike të Grave të Kosovës - G7;
26. Koordinatorja e Forumit Ekonomik të Gruas;

### Përfaqësuesit nga Ambasadat dhe misionet diplomatike:

27. Përfaqësues nga Ambasada Amerikane;
28. Përfaqësues nga Ambasada e Zvicrës;

### Përfaqësuesit nga partnerët ndërkombëtarë:

29. Drejtori i Zyrës së Bankës Evropiane për Rindërtim dhe Zhvillim në Kosovë (BERZH);

Pjesëmarrës të tjerë:

1. Zyra e Inspektorit të Përgjithshëm;
2. Këshilltarja Ligjore e Kryeministrit;
3. Përfaqësues shtesë nga BERZH;
4. Përfaqësues nga OEGJK;
5. Përfaqësues nga DhTIK;
6. Përfaqësues nga Ministria e Eknomisë;
7. Përfaqësues nga Ministria e Drejtësisë.